



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 10

Rrogozhinë, më 19.07.2024 ora 09 : 30^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.3069.Prot datë 16.07.2024, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr. 9, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.06.2024.
- 3- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2024 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës Nr. 2107, datë 10.05.2024, të studim projektimit dhe të fondit për ‘Rehabilitimi i Rezervuarit i Domen’ fshati Domen, Njësia Administrative Kryevidh”.
- 6- Informacion nga drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, mbi realizimin e të ardhurave për 6 - mujorin e parë të vitit 2024.
- 7- Informacion nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë mbi rezultatet dhe problematikat për vitin shkollor 2023-2024.
- 8- Informacion mbi realizimin e treguesve ekonomikë të Njesisë së Ujësjellës - Kanalizime Rrogozhinë si dhe masat e marra për furnizimin normal me ujë të banorëve të Bashkisë dhe të zonave turistike (plazhi i Spillesë dhe i Vilë - Bashtovës) për periudhën Maj 2023- Maj 2024. *(Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen paraardhëse të datës 26.06.2024).*
- 9- Të ndryshme.
 - *Shqyrtim i kërkesës së nxënësit Aleks Xhavara për mbështetje financiare për mundësimin e studimeve të larta.*
 - *Shqyrtim i kërkesës së poetit z. . Xhelal Tosku për sponsorizim libri.*
 - *Të tjera.*



Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Merilin Saraçi, Besnike Coraj, Saimir Cani, Isa Halili, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Fatmira Thartori, Shpati Kolgega, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Sokol Gosa, Lije Dedej, Mitat Daja, Altin Tosku, Fatbardha Sina, Gezime Met-hasani, Enver Memolla, Renato Kalemi, Erind Tosku.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Dafina Nuka - Përgjegjëse e Njesisë Operative Ujësjetellës Kanalizime Rrogozhinë sha.
4. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
5. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ledian Hasani - Drejtor i mirëqënies dhe kujdesit social.
7. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
8. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
9. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
10. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vadijes.
11. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 12- Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA



Mukades Gixhari . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje : Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Merilin Saraçi, Besnike Coraj, Saimir Cani, Isa Halili, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Fatmira Thartori, Shpati Kolgega, Mukades Gixhari.

Lexojmë konfirmimin ligjor të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për Vendimet e Këshillit Bashkiak të datës 26.06.2024.

Vendim nr .32, datë 26.06.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2024 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%” nuk është akt me karakter normativ.

Vendim nr .33, datë 26.06.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2024 nga fondi i pushtetit vendor” nuk është akt me karakter normativ.

Vendim nr .34, datë 26.06.2024 “Për shpalljen e emergjencës në rezervuarin e Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryeveidh” nuk konfirmohet pasi objekti i vendimit nuk është kompetencë e këshillit bashkiak referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore i ndryshuar, nenit 54 si dhe ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” nenit 39, 40 e vijues.

Vendim nr .35, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr.37, datë 27.12.2023, ‘Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë për vitin 2024’ “, me qëllim përfshirjen në këtë vendim për caktimin e nivelit të pagave të Punonjësve të Policisë Bashkiake Rrogozhinë” konfirmohet.

Vendim nr .36, datë 26.06.2024 “Për miratimin e projektit, “Organizim eventit muzikor dhe humoristik në qytetin tonë për periudhën e stinës së verës datë 28 Korrik 2024” nuk konfirmohet pasi fondi i miratuar në këtë vendim është parashikuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak për Buxhetin e vitit 2024, dhe mund të përdoret rast pas rasti sipas kriterëve ligjore përkatëse, si dhe Këshilli Bashkiak miraton rastet e parashikuara në nenin 44, pika a të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Mukades Gixhari . Para se të kalojmë në pikën e parë ju informoj që Këshilltari z. Enver Memolla ka dhënë dorëheqjen si kryetar i grupit të majtë dhe në këtë pozicion është komanduar këshilltarja znj. Alime Hoxha, deri në zgjedhjet që do të zhvillojnë këshilltarët e grupit të majtë për këtë qëllim. Kalojmë në miratimin e pikës së parë.

Indrit Dedej . Kryetare për këto vendimet që nuk janë miratuar ka ndonjë shpjegim.

Mukades Gixhari . Ftojme drejtoreshën juridike e cila do na relatojë. Fillojmë me shpalljen e emergjencës vendimi nr.34.

Enkela Ballabani . Me ligjin që është në fuqi situatat e emergjencës kalohen me VKM prandaj dhe nuk është konfirmuar.



Indrit Dedej . Po na e keni sjellë 3 herë rresht.

Enkela Ballabani . Projektvendimi që është për tani nuk është për shpalljen e situatës së emergjencës por është siç duhet për marrjen e fondeve për miratimin e kërkesës që i dërgohet prefektit të qarkut, më pas është miratimi i fondit që supozohet që do sjelli AKMC-ja për rezervuarin e digës së Domenit kjo është linja ligjore që duhet ndjekur.

Indrit Dedej . Keni dijeni ju që fshati Domen nuk ka rezervuar fare? Rezervuari është i Kaziesit , ai rezervuar ka 15 vjet që është fshirë nga harta si rezervuar.

Isa Halili . Se kuptoj për çfarë e sillni këtë?

Indrit Dedej . Eventin nuk e kanë sjellë më, por rezervuarin e kanë sjellë prap, tani ...

Isa Halili . Mesa e njoh unë atë territor atje... pastaj çfarë do ndërhysh kur ai nuk sjell pasoja.

Mukades Gixhari . Tani për vendimin nr.36.

Enkela Ballabani . Tani sa i përket vendimit nr.36, sipas përgjigjes që ka kthyer Prefekti u tha që në buxhet për organizimin e një aktiviteti është parashikuar tek buxheti i vitit 2024.

Fatmira Thartori . Nuk e kemi miratuar ne atë, herën e dytë e kemi miratuar.

Isa Halili . Ne sikur e kundërshtuam këtë.

Enkela Ballabani . Projektvendimet kanë firmat që vendosen kush e ka konceptuar , në momnetin që firma jonë nuk është aty do të thotë që nuk ka kaluar tek zyra juridike. Në momentin që nuk na e sjellin për mendim juridik përpara se të bëjmë projektvendimet edhe ne...

Indrit Dedej . Ju jeni zyra e fundit që nga ana ligjore ...

Enkela Ballabani . Patjetër por kur nuk më kërkojnë mendim juridik.

Mukades Gixhari . z. Hekuran.

Hekuran Xhani . Çdo vendim duhet të kalojë patjetër në dorën tuaj për të marrë vlerësim juridik edhe sekretari i këshillit nuk duhet të pranojë këtu asnjë vendim, se ne nuk jemi të specializuar të



njohim mirë ligjet ndoshta të qeverisjes vendore dhe i kemi diskutuar por VKM ne miratojmë dhe biem ndesh me vendimin vendimet që nxjerr Këshilli i Ministrave. Lidhur me rezervuarin e Domenit unë nuk kam informacion por unë mendoj që burimi i financimit do të kërkohet të mbulohet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Të nderuar kolegë unë jam që nuk e njoh në terren le të ngrihet një komision të shkojë të verifikojë por këto janë fonde që vijnë nga Mbrotja Cicile vijnë nga qeveria. Është një shumë e konsiderueshme me mbi 570 milion lekë edhe me ja sjellë njësisë administrative këto lekë unë do të jem plotësisht dakord në rast se këto lekë vijnë nga mbrojtja civile Tiranë t'i shërbejë komunitetit. Tani problemi qëndron këtu përderisa nuk preken financat e bashkisë ne nuk kemi pse të dalim kundër një investimi që i kthehet asaj zone. Këtu nuk duhet vendim por duhet miratim, a është dakord këshilli që ky fond të shkojë ne nuk duhet të jemi kundra sepse është një vlerë e konsiderueshme që i kthehet atij komuniteti, pra atje nuk ka kush të hedhi në hartë njolla ka qenë ai ka qenë një rezervuar i cili ka dalë jashtë funksioni sepse ka shpërthyer diga. Qeveria sot mendon ta rehabilitojë edhe t'i shërbejë me ujë asaj zone, ne këtu si këshill përfaqësojmë ata qytetarë që na kanë sjellë e para dhe e dyta mbrojmë interesin e atyre që ndodhen në Domen e qoftë në Sinaballaj e qoftë në Mlik. Ky fond duhet në rast se vjen se këtë nuk e mbulon dot bashkia ...

Isa Halili . Jo bashkia me jo, unë jam shumë dakord me dashamirësinë e këtyre për të bërë një gjë të mirë por këta minimalisht duhet të vijnë me një informacion ku thonë ne kemi kaq lekë për këtë arsye për këtë motiv për këtë gjë , këta vijnë pa informacion dh ethonë ne kemi kaq lekë do bëjmë këtë në Domen. Dhe këta nuk e dinë njëherë që atje nuk ekziston një rezervuar se këta nuk e njohin zonën. Tani unë që e njoh ose dikush tjetër që e njeh jep informacion këtu minimalisht për të gjithë ata që na ndjekin dhe thotë ore zotëri këtu do vihet kaq lekë për këtë punë për këtë motiv dhe do bëhet kjo gjëja unë nuk jam dakord që do bëhet një gjë, jam shumë dakord për ata njerëz atje që vjen një investim se unë e di sa i rëndësishëm është sidomos për periudhën e verës e di sa i rëndësishëm është uji por këta janë ndjesë fodulla në informacion këta nuk tregojnë pse do bëhet që ta dijmë për çfarë motivi do bëhet. E di pse po them do ta lidh thjesht para tre vitesh njësisë administrative Sinaballaj i vjen 1.2 milion euro për rrjetin e ujërave pra ujin e pijshëm është bërë gjithë investim, jo që nuk ardhur uji tek dera e çdo njeriu, jo se janë paguar ato lekë. E para në Sinaballaj nuk kishte një familjar që të thonte që ka probleme me ujin e dyta ...

Mukades Gixhari . Ka pikën e vet të rendit të ditës.

Isa Halili . Mirë që u bë ajo gjëja mirë që janë hedhur lekët por qytetarët nuk marrin shërbime...

Alime Hoxha . Është për t'u bërë tek të ndryshme e diskutojmë.



Shpati Kolgega . Rezervuari ekziston nuk është ky problemi...

Alime Hoxha . Edhe diçka meqë po thonë që nuk ekziston rezervuari para 2 vitesh kanë ndenjur forcat e policisë 24 orë atje.

Isa Halili . Para dy vitesh, po sot që po flasim është njësoj?

Lulzim Hasa . Kryetare unë jam këshilltar i asaj zone, rezervuari është ndërtuar në vitet e atoj sistemi, ku i shërben zonës për vaditje, të bëhet funksional është shumë mirë sepse ka shumë toka poshtë që kanë nevojë për vaditje.

Silvana Aliu . Nuk e ke ne Domen.

Lulzim Hasa . Nuk ka lidhje është gryka lugina ku ndahet Domen me Kazien nuk asnjë të keqe është vija ndarëse e dy fshatrave është luginë.

Shpati Kolgega . Kryetare mba pak radhë se e fillova nuk e mbarova.

Hekuran Xhani . Unë nuk të ndërpreva.

Shpati Kolgega . Tani unë e mora ma dha Kryetarja fjalën

Hekuran Xhani . Kryetarja nuk mund të shkeli të drejtën time dhe të ta japi ty. Unë prap desha me ju drejtuar Lulit si këshilltar i asaj zone për ta pyetur se unë nuk e njoh atë zonë pikërisht prandaj ju drejtova këshilltarëve të grupit tim këtu që ne të mos dalim kundërshtarë për një fond që e sjell qeveria dhe i shkon komunitetit, këtu thotë që investimin do ta kryejë Mbrojtja Civile Kombëtare.

Mukades Gixhari . Z.Shpati vazhdoje bisedën ndjesë për ndërprerjen.

Shpati Kolgega . Ajo që po thoja është që patjetër të rregullohet përderisa është fondi, problemi i Domenit besoj nuk është rezervuari është rruga, pra çojmë 600 milionë lekë në Domen për rezervuarin dhe atje nuk karrugë për të shkuar. E kuptoj këto janë dy gjëra të ndryshme fondi unë e kuptoj që nuk është një fond nga rezervuari dhe do ta çojmë e kuptoj këtë pjesë mbase duhet të rregullojmë rrugën njëherë pastaj fillojmë se ai është problemi kryesor i Domenit, rezervuari po mund të jetë emergjencë



Lulzim Hasa . Nuk futesh nga Domeni, futesh nga Kaziet.

Mukades Gixhari . Dëgjojmë pak kryetarin.

Edison Memolla . Ta shpjegoj dhe unë pak më gjatë se ndoshta ky rezervuar ka tre faza kjo është faza e parë që ndërhyhet dhe bëhet nëse ka çarje kanë shkuar specialistët e AKMC kanë shkuar të gjithë dhe është vendosur që ky rezervuar të rehabilitohet. Këtu bëhet fjalë për të forcuar digën që çarja e kësaj dige mos sjelli pasoja në familjet poshtë. Pastaj ka dy faza tjera që siç thotë dhe Shpati duhet me shkuar atje se si do shkojë skrepi dmth janë të gjithë të parashikuara dhe ky shkon dhe dy herë kq që të rregullohet gjithë zona. Këtu duhet të mbyllim digën që të mos kemi probleme me jetë njerëzish këtu është e gjithë, projekti është bërë nuk e di nëse e keni të bashkëngjitur projektin. Në qoftë se ka paqartësi unë jam i gatshëm është një gjë që duhet ndërhyrë.

Isa Halili . Çfarë dëmsh i sjell nga çarja zonës?

Edison Memolla . Nëse çahet nuk e di sa m³ ujë ka, nëse ajo çahet mbyten shtëpiat e njerëzve i merr përpara çfarë të gjejë.

Isa Halili . Qartë, sa banorë ka në këtë zonë?

Edison Memolla . Është komplet fshatin e Kazies që ka qenë lart ka zbritur është poshtë...

Isa Halili . Po e njoh mirë. E dini se sa persona jetojnë atje?

Edison Memolla . Normal që e dimë.

Isa Halili . Atëherë besoni që 600 e ca milionë lekë...

Edison Memolla . Nuk janë 600 e ca janë 570 milionë.

Isa Halili . 550 mijë euro i jepni qytetarëve, i sillni këtej në vende më të mira ekonomike do ishte gjëja më e mirë dhe të bëhet nami atje në Domen, sepse aq pjesëtarë në dijeninë time janë 11 persona që jetojnë atje. Aty tek ajo Kazie që thoni ju dhe ato nuk jetojnë 365 ditë aty.

Edison Memolla . E di ku po flasim? Kazie po flasim bregun e detit shkon në det kjo mbytet detin kopmplet Kazie ke fshatin poshtë nga...



Isa Halili . Në dijeninë time nuk e di që të ketë pasur ndonjëherë këto probleme nga ky rezervuar.

Edison Memolla . Ne nuk kemi ardhur me mendjen tonë këtu kanë shkuar ekspertë atje.

Isa Halili . Atë po diskutojmë se nuk e kam me ty.

Edison Memolla . Unë jam dakord që këtë fond ta çojmë në rrugët e Rrogozhinës shumë bukur nuk ka lidhje kjo ky është një zë i ndryshëm.

Isa Halili . Problemi është këtu ne duhet të kuptojmë një gjë përpara se 5 lekë që të investohen janë me lekët tona edhe kjo...

Edison Memolla . Është zë i veçantë.

Isa Halili . Të lutem edhe kjo ne paguajmë dhe taksat i shkojnë shtetit. Tani a ka mundësinë me dashamirësinë më të madhe ato 5 lekë që vijnë nga shteti që i kemi ne nga taksat tona t'i hedhim për ca gjëra më imediate në këtë vend.

Edison Memolla . Ka më imediate se të vriten njerëzit, se kuptoj?

Isa Halili . Kush ka dalë në këto përfundime?

Edison Memolla . Ky rezervuar besoj që e keni parë dhe nëpër media...

Isa Halili . Po pra, po ku janë këto analiza kush i ka bërë këto analiza ku janë këto ekspertët, si kanë dalë këto konkluzione ky është gjithë problemi i çështjes?

Edison Memolla . I ke bashkëngjitur në projekt, ka ardhur AKMC ka sjellë projekt të saktë të gjithë gjërave nuk jemi ne inxhinierë që të dalim në vendim.

Isa Halili . Nuk po them jemi ne jo.

Edison Memolla . Kemi marrë një shkresë ne, kemi nisur nismën kemi marrë dhe banorët e zonës që ky rezervuar është i rrezikshëm, që ju lutem merrni masa. Pas kësaj kanë shkuar ekspertët e AKMC-së, të Prefekturës kanë shkuar të gjithë në vend kanë mbajtur relacione shpjeguese, kanë mbajtur që ka nevojë për ndërhyrje emergjente dhe ne kemi vazhduar procedurën është bërë projekti.



Silvana Aliu . Të ngrehet një komision.

Edison Memolla . Jeni inxhinierë ju, se po flisni gabim hajde shkojmë të gjithë.

Isa Halili . Është si puna e asaj shkollës që u bë në Vilë Bashtovë u hodhën gati 1 milion euro për të bërë një shkollë që ka 9 nxënës brenda.

Edison Memolla . Nuk ka shkollë 1 milion euro.

Isa Halili . Po kështu e di unë mund të jetë 800, pra po hedhim ca lekë që i shërbejnë pak njerëzve që vlera e lekut me shërbimin që ...

Edison Memolla . Sa kushton një jetë njeriu si e vendosni këtë punë?! Kushton jeta njeriut nuk është kështu...

Isa Halili . Jam dakord që kushton pa diskutim po.

Edison Memolla . Tani do vadisin arat, ti don t'i vrasësh nëse do me i vra mos e kalojmë bëni çfarë të doni.

Alime Hoxha . Ne nuk e kemi filluar akoma rendin e ditës.

Silvana Aliu . Ne po flasim pse e ka kthyer prefekti.

Edison Memolla . Prefekti e ka kthyer për shpalljen emergjencës nuk kishte kompetencë prefekti edhe vendimi jonë, ka ardhur gabimisht ashtu titullimi i saktë është ky e njëjta gjë që kaluam herën që kaloi.

Indrit Dedej . Rregullatori është prefektura, unë kam qejf që ky projektvendim t'i shkojë zyrës juridike, ta verifikojë mirë zyra juridike hajde mbledhjen tjetër ta kalojmë.

Edison Memolla . Nuk ka lidhje ai projektvendim është bërë gabim nga ana jonë ne mbajmë përgjegjësinë tonë. Ky është projektvendimi i saktë që duhet të kalojë.

Indrit Dedej . Të jap fjalën që mbledhjen tjetër...

Edison Memolla . Nuk ka lidhje të jap fjalën mos e kaloni ishalla nuk ndodh gjë mbani ju



përgjegjësi. Unë nuk e kam për shtëpinë time.

Hekuran Xhani . O Indrit po konsumojmë shumë kohë për një problem që në fund të fundit këshilli i ministrave nuk na pyet fare nëse e sheh emergjencë e bën atë.

Isa Halili . Po për çfarë e sjellin?

Hekuran Xhani . Z. Isa ne kemi ardhur në mbledhje për të zgjidhur problemet, jo për të shtyrë kohën ti erdhe këtu the me vonesë koha është flori. Tani problemi qëndron këtu këtë fond e sjell zyra e emergjencave të kombit, ka dhe specialistë atje në terren unë kam punuar 10 vjet sekretar i përgjithshëm i federatës Peqin-Kavajë dhe kam mbuluar gjithë këto zonat bashkë me Enver Bykun. Ka emergjencë atje ka fjetur ministri atje ka qenë në qeverinë e partisë demokratike, kemi fjetur atje gjithë natën tek ai rezervuari...

Silvana Aliu . Nuk mund të kalojmë një që e ka kthyer prefekti.

Edison Memolla . Po ç'lidhje ka? Doni ta kaloni mos e kaloni.

Mukades Gixhari . Fillojmë me rendin e ditës? Do shkojmë prap atje.

Hekuran Xhani . Ta ezaurojmë këtë pikë kemi gjysëm ore që po merremi.

Edison Memolla . Indrit po sikur të çahet diga do mbash ti përgjegjësi?

Indrit Dedej . Do mbaj unë përgjegjësi se ka 20 vjet ai rezervuar .

Edison Memolla . Po ç'lidhje ka? Ka të tjerë që kanë 30 vjet para nuk kanë probleme por ky ka probleme.

Indrit Dedej . Hajde shkojmë bashkë është bosh fare.

Edison Memolla . Hajde shkojmë që tani, po në qoftë se nuk është ashtu? Hajde shkojmë ndalojmë atje direkt pas kësaj.

Hekuran Xhani . Ku është qëllimi që kjo nuk po kalon? Unë jam këtu me votën tënde ka një problem tani, kur nuk preken financat e bashkisë unë e quaj kohë të humbur këtë bisedë. Ky vendim bazohet në ligj tani faktikisht kjo do bëhet me VKM, bëni çfarë të doni unë e quaj kohë të humbur këtë është një debat jo produktiv.



Mukades Gixhari . Jeni dakord me rendin e ditës? E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Z. Isa për rendin e ditës je dakord ? Po. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Pika 2, Miratim i procesverbalit Nr.9, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.06.2024. Jeni dakord për miratimin e këtij procesverballi? Vota pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3, Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton Drejtori i Mbrojtjes dhe Kujdesit Social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian.

-Largohet nga mbledhja z. Shpati Kolgega në minutën e 28:30 të zhvillimit të mbledhjes, në sallë mbeten 11-këshilltarë.

Ledian Hasani . Janë 18 familje me një fond prej 77 mijë lekësh.

Mukades Gixhari . I keni materialet para ndonjë pyetje për z. Ledian për pikën 3 për ndihmën 6 %.

Indrit Dedej . Ndonjë shpjegim për dy vendimet e herës së kaluar.

Mukades Gixhari . Mënyra se si është shprehur z. Ledian që nuk është akt me karakter normativ, që përkthehet miratohet?

Ledian Hasani . Po po përveç kësaj kemi bërë relacionin për familjet.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje në lidhje me z. Ledian. E hedhim në votim.

-Largohet nga mbledhja z. Isa Halili në minutën e 30:00 të zhvillimit të mbledhjes, në sallë mbeten 10-këshilltarë.

-Pas një pushimi 4 minutësh kthehet në mbledhje z. Shpati Kolgega, duke e çuar në 11-Këshilltarë pjesëmarrjen në mbledhje. Rifillon mbledhja.



Mukades Gixhari . Atëherë hedhim në votim pikën 3. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr.37. Miratohet me 11- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3051.Prot datë 15.07.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2024 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%” .

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, të rendit të ditës miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me z. Ledian.

Ledian Hasani . Në total janë 18-familje shuma është rreth 94 mijë lekë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike? Keni ndonjë pyetje ? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr.38. Miratohet me 11- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3020.Prot datë 12.07.2024,“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.

Mukades Gixhari . Të nderuar këshilltarë kemi dhe pikën 9, meqë kemi dhe drejtorin z. Ledian jeni dakord që ta përfshijmë që të largohet zotëria?

Ledian Hasani . Nuk ka problem se rri unë.

Mukades Gixhari . Atëherë vazhdojmë me rendin e ditës. Pika 5, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës Nr. 2107, datë 10.05.2024, të studim projektimit dhe të fondit për ‘Rehabilitimi i Rezervuarit i Domen’ fshati Domen, Njësia Administrative Kryevidh”. Drejtoresha e shërbimeve mbështetëse znj. Valmira Troka dhe drejtoresha juridike.

Edison Memolla . Është një fond që digjet në Shtator.

Hekuran Xhani . Indrit këto janë fonde të drejtorisë së emergjencave këtë fond po nuk e morëm



ne edhe njëherë ne jemi këtu për t'i shërbyer qytetarëve tanë. Unë taserën e partisë kam 30 vjet që e kam por e kam lënë në shtëpi kur vi këtu. Një fond që i vjen komunitetit tim le të jetë në Mlik le të jetë në “Gur të lëmuar” le të jetë në Thartor unë nuk mund ta djeg ky është fond që nuk e ka Bashkia. Tani ky i sjell qytetarëve të bashkisë 570 milion lekë. Ti thua do ta çojmë muajin tjetër, çoje pas vitit të ri.

Mukades Gixhari . Ja të dëgjojmë drejtoreshën juridike.

Alime Hoxha . Faktikisht kjo është pak e rëndë për ne do duhej të ishte edhe për ju si zyrë juridike. Tani ai vendim nuk ishte kompetencë e këshillit bashkiak ishte e këshillit të ministrave...

Edison Memolla . Ka këshilla tjerë me vendime këshilli që e kanë marrë, ke bashkitë fjinje që e kanë marrë e kanë bërë. Prefektura jonë ka menduar që ta kthejë për një...

Indrit Dedej . Mbajmë ne përgjegjësi personale, unë dua ta kaloj ligjërisht hajde muajin tjetër...

Edison Memolla . Po ligjërisht është ajo.

Enkela Ballabani . Ligjërisht është.

Indrit Dedej . Në momentin që unë e kaloj, e anashkaloj prefekturën dhe ka dy rrugë ose të hedhin në gjyq...

Alime Hoxha . Tani që duhet një kordinim i mirë se nuk është projektvendimi i parë që na kthehet nga prefektura, kështu që ju duhet të angazhoheni pak më tepër tek kjo pjesë, që në anën ligjore ne të mos çalojmë, se është e patolerueshme çojmë projektvendime në prefekturë dhe të na i kthejë prefektura mbrapsht se herën e parë nuk ishte ligji, herën e dytë nuk është kompetencë e jona, herën e tretë i ka miratuar njëherë këshilli ato fondet për projekte. Ndërsa sa për projektvendimin që po themi, ky nuk ka lidhje me atë, ky është një projektvendim tjetër, pra ky i ka të detajuar është për kërkesën e fondit dhe nuk besoj se ka lidhje me atë projektvendim që na është anuluar nga... nuk kemi pse kapemi prap nga ana juridike derisa ky është një projektvendim ... projektvendimi që ka kthyer prefekti nuk ka lidhje me këtë projektvendim këtë po flas.

Indrit Dedej . Ta rregullojnë të vijnë muajin tjetër...



Alime Hoxha . Po e kanë rregulluar, ky është projektvendim tjetër.

Fatmira Thartori . Nuk është puna për të tjerë është për komunitetin...

Indrit Dedej . Sa e dua unë komunitetin nuk besoj ta duash as ti.

Alime Hoxha . O Indrit çfarë do të bëjë ty që do e sjelli muajin tjetër?

Lulzim Hasa . Do i lutemi Indritit ne, Indriti përfiton se është një votë këtu dhe bie projektvendimi. Ti mos përfito që për një votë digjet projektvendimi.

Indrit Dedej . Unë nuk përfitoj në asnjë lloj rasti.

Lulzim Hasa . Ti ngul këmbë kot çfarë ke.

Indrit Dedej . Mua duhet të më mbushet mendja...

Edison Memolla . Çfarë do ti që të mbushet mendja?

Indrit Dedej . Do shoh do shkoj në terren.

Lulzim Hasa . E di ti si funksionon...?

Mukades Gixhari . Indrit u kërkua mbledhje jashtë radhe për këtë çështje.

Enkela Ballabani . Në VKM-në Nr.536 që ka dalë në vitin 2023, përcaktohen kriteret dhe procedurat për akordimin e fondeve dhe marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive. Në pikën 7 të kësaj VKM-je kërkohet vendimi i këshillit bashkiak në pikën “b” ku përcaktohet destinacioni i përdorimit të fondeve të kërkuar për emergjencën civile që do të thotë, kërkohet mendimi i këshillit bashkiak që këto fonde që i ka AKMC-ja të miratohen vetëm për ...

Hekuran Xhani . Jeni dakord që të shkojnë tek rezervuari i Domenit kaq, se letra këtu ka shumë.

Indrit Dedej . Të ma kishe sjellë përpara procedurën ta shihja unë ta lexoja.

Edison Memolla . Aty i ke përpara o Indrit.



Enkela Ballabani . Aty ke dhe relacionin dhe kërkesën që i është drejtuar prefektit të qarkut që i është drejtuar dhe AKMC-së pastaj.

Indrit Dedej . Është diçka që nuk e shoh të arsyeshme gjithë këtë nxitim kot, muajin tjetër hajde ta votojmë.

Shpati Kolgega . Kryetare më fal mos e vini këshillin në presion që digjen... i sillni në kohën e duhur. I sollët herën e kaluar i sollët gabim iku një mbledhje kot, tani thoni votojini ju se digjet fondi, sillini në kohën e duhur këtu ishit herën e kaluar thatë është emergjencë e diskutuam vetem dy sekonda e votuam unanimitisht të gjithë bashkë, tani vjen radha digjet na thoni po nuk e miratuat ju na digjet, na e lini ne topin që po e djegim ne fondin.

Indrit Dedej . E mësuam njëherë me skrepin e kaluam u dogj, o burra se po digjet jashtë radhe e kaluam prap...

Shpati Kolgega . Çfarë ndodhi me skrepin?

Hekuran Xhani . U dogj 50 milion fondi i emergjencave civile, me skrepin e parë nuk arritëm të bëjmë prokurimin e fondit ikën 50 milion, 50 milion ju bë dëm qytetarëve të bashkisë së Rrogozhinës.

Alime Hoxha . Kryetare mos e humbasim kohën, si do bëhet ose do e kalojmë?

Indrit Dedej . Unë nuk e kaloj.

Edison Memolla . A të kanë ardhur 5 ditë dokumentet para, tani mos flit kot sdo ta kalosh është... a ju kanë ardhur dokumentet 5 ditë para sipas afatit, a i keni lexuar dokumentet, tani unë mendoj që projektvendimi më i saktë se kaq nuk do ju vinte ka ardhur me projektin bashkëngjitur, ka ardhur me të gjitha bashkëngjitur që nga A deri tek Zh. Tani nëse ti nuk do ta kalosh mos e kalo është puna jote ke të drejtën tënde.

Indrit Dedej . Të ishe kaq i interesuar ti kryetar duhet të vijë në mbledhjen e kolegjit të kryetarëve.

Edison Memolla . Kam ardhur unë po nuk erdhët ju dje, erdhët në mbledhje ju dje?

Indrit Dedej . Këshilli Bashkiak nuk ka pasur dëgjësë.



Edison Memolla . Unë kam qenë dje këtu, pardje kur keni pasur komision ju nuk keni ardhur mos flisni kot tani mos u hidhni degë më degë. Ky është projektvendim i kompletuar plotësisht që nga A deri tek Zh-ja.

Indrit Dedej . Kryetar pa dëgjuesë publike...

Edison Memolla . Çfarë dëgjuesë publike do mbyten njerëzit është emergjencë.

Indrit Dedej . Dëgjuesë në kohë pushimesh.

Edison Memolla . Mbaro këtë pastaj dalim... ishte online pse nuk erdhët.

Indrit Dedej . Online nuk e ke fare...

Edison Memolla . Ka 10 ditë që e keni.

Alime Hoxha . Kalojmë në pikën tjetër.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6-të, Informacion nga drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, mbi realizimin e të ardhurave për 6 - mujorin e parë të vitit 2024. Drejtoresha e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik znj. Marsida Thartori.

Marsida Thartori . Përshëndetje! Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëj me dije që drejtoria e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik në 6-të mujorin e parë 2024 është angazhuar për të bërë të mundur realizimin e objektivave vjetor.

Është realizuar pritja, shërbimi dhe sqarimi i të gjithë taksapaguesve si për bizneset ashtu dhe për familjarët në bashkidhe të gjithë Njësitë Administrative.

Janë shpërndarë të gjithë njoftim-detyrimet për bizneset në të gjithë njësitë administrative dhe në qytetin e Rrogozhinësi dhe po vijohet të punohet me njoftim detyrimet për taksapaguesit familjarë.

Janë përditësuar regjistrat fizik dhe elektronik me të ardhurat e realizuara si për bizneset ashtu dhe për familjarët .

Janë plotësuar dosjet për të gjithë bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar në territorin e bashkisë Rrogozhinë.

Janë regjistruar të gjithë subjektet e reja që kanë filluar aktivitetin rishtazi përgjatë vitit 2024 (sipas QKB).

Janë kryer mbledhje mujore nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik mbi



raportime, problematika dhe përditësime të punës së kryer nga të gjitha zyrat e shërbimit. Janë njoftuar me shkrim (letërkujtesa) të gjithë subjektet tregtare, biznesi i vogël dhe i madh për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për periudhën 2011-2023 ku për subjektet e interesuara kemi ofruar mundësinë e pagesës me këste. Për subjektet debitore janë marrë masa bllokimi të llogarive bankare, automjeteve si dhe pasurive të paluajshme.

Janë kryer rakordimet e të ardhurave në degën e thesarit Kavajë dhe drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës. Janë dërguar nga drejtoria e transporteve të gjithë debitorët e mjeteve të përdorura ndërsa ASHK i janë dërguar vazhdimisht shkresa për rakordime por nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Janë lidhur Akt-Marrëveshjet me subjektet tregtare që ushtrojnë aktivitetet përgjatë vijës bregdetare.

Janë përpiluar shkresa në funksion të punës me institucione të tjera me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara si dhe i janë kthyer përgjigje të gjithë shkresave të ardhurave të dhëna që kërkojnë mbi punën tonë.

Si rezultat i punës së kryer nga drejtoria e të ardhurave të ardhurat për 6-të mujorin e parë 2024 janë 82671231.00 lekë ose 35% nga plani vjetor.

Krahasuar me 6-të mujorin e parë të vitit 2023 janë realizuar rreth 26.153.664 lekë më shumë.

Për më tepër detaje janë tabelat dhe grafikët përkatës sipas zërave.

Këtu kam grafikët me të ardhurat e planifikuara për 6 muaj. Kam një grafik që është krahasimi zë për zë ...është dhe tabela tjetër që është plani dhe fakti.

Edison Memolla . Jo çdo gjë politike fushata ka mbaruar tani jemi për gjithë komunitetin. Sugjerimet që na dhatë do t'i marrim parasysh, shumë faleminderit për sugjerimet.

Marsida Thartori . Ka biznese që pezullohen dhe hapen gjatë gjithë vitit periudha Maj Qershor nuk është një numër i saktë.

Indrit Dedej . Një shifër mund ta kesh ti.

Marsida Thartori . Mund ta sjell mbledhjen e ardhshme. Nëse shohim psh tokën bujqësore kaq ka qenë vjet kaq është sivjet, tatimi mbi ndërtesat kaq ka qenë kaq është ndërsa zëri që ka diferencë është karburanti, të ardhurat nga autorizimi për karburantet.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër? Ju falenderoj. Kalojmë në pikën 7-të, Informacion nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë mbi rezultatet dhe problematikat për vitin shkollor 2023-2024. Drejtoresha e ZVA-së znj. Alime Hoxha.



Alime Hoxha . Në përgjigje të kërkesës së Këshillit Bashkiak Informacion nga zyra arsimore kemi numrin e nxënësve që janë... Kopshti i Rrogozhinës funksionon me drejtori më vete dhe ka gjithsej 130 fëmijë nga këto kemi me aftësi ndryshe Arsimi fillor 10, Arsimi i mesëm i ulët 9 dhe arsimi i mesëm i lartë 4. Ka pasur largime gjatë vitit dhe janë larguar gjithsej 65 nxënës nga të cilët 35 janë me arsimin e mesëm të ulët dhe arsim fillor dhe 30 janë me arsim të mesëm të lartë. Largimet janë kryesisht jashtë vendit. Mësimi është zhvilluar normalisht përveç dy shkollave në Lekaj dhe Spille për shkak të mungesës së godinës mësimi zhvillohet me dy turne. Për shkollën Lekaj e dimë që është në ndërtim shpresojmë që vitin e ardhshëm futet shkolla në funksion dhe kjo problematikë zgjidhet. E kemi akoma problematikën e shkollës Spille ne si këshill miratuar një projektvendim vitin e shkuar. Procesi mësimor ka vijuar rregullisht në të gjithë institucionet. Janë zhvilluar me sukses provimet e arsimit fillor për klasat e 5 në përgjithësi rezultatet kanë qenë të kënaqshme. Janë zhvilluar gjithashtu olimpiadat që zhvillohen në arsimin e mesëm të lartë dhe në shkollën 9-vjeçare është për tu theksuar që kemi patur pjesëmarrës në fazën e tretë në marsimin e mesëm të lartë në lëndët gjithë letërsi, matematikë dhe letërsi. Gjithashtu shkollat kanë zhvilluar aktivitete sensibilizuese dhe argëtuese. Infrastruktura pjesa më e madhe është e mirë por kemi nevojë dhe për ndërhyrje në disa shkolla siç është shkolla Haki Skuqi, Spille Domen, Ballaj, Kalush, Stërbeg. Furnizimi me bazë materiale ka patur problematika dhe furnizimi për orën e edukimit fizik. Problematika kryesore e arsimit është rënia e numrit të nxënësve në Institucionet arsimore dhe për rrjedhojë shkurtimi i vendeve të punës për punonjësit arsimorë. Gjithashtu është kusht që të ketë ujë të rrjedhshëm energji elektrike dhe internet.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje z. Indrit Dedej.

Indrit Dedej . Nuk keni vartës në institucionin tuaj, a je në konflikt interesi?

Fatmira Thartori . Zonja nuk merr projektvendime që ne ta mbështesim, nëse do ishte projektvendim atëherë do ishte konflikt interesi.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër për drejtoreshën? Faleminderit. Vazhdojmë me pikën 8-të Informacion mbi realizimin e treguesve ekonomikë të Njesisë së Ujësjellës - Kanalizime Rrogozhinë si dhe masat e marra për furnizimin normal me ujë të banorëve të Bashkisë dhe të zonave turistike (plazhi i Spillesë dhe i Vilë - Bashtovës) për periudhën Maj 2023- Maj 2024. (Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen paraardhëse të datës 26.06.2024). Raporton për njësinë operative të ujësjellësit drejtoresha Dafina Nuka. Përsëndetje znj. Dafina.

Dafina Nuka . Përsëndetje! Në përgjigje të kërkesës së Këshillit Bashkiak po ju paraqesim



treguesit ekonomikë të Njesisë Operative Rrogozhinë viti 2023. Numri i aktual i kontratave sipas tre kategorive e konsumatorëve, llojit të matjes (afrofe ujëmatës apo tarifë fikse shërbimi) llojit të shërbimit (ujë apo dhe kanalizime). Numri total i kontratave 5 722 buxheti 5715 realizimi 100%. Norma e mbulimit me ujësjellës e popullatës në zonën e shërbimit 16743, buxheti 16725 realizimi 100%. Numri i lidhjeve me matës 5551, buxheti 5715 realizimi 97%. Numri i kontratave familjare 5401 plani 5395 buxheti, realizimi 100%. Numri i kontratave biznes 259 realizimi 100 %. Numri i kontratave institucion 62 plani realizuar 61 ose 102 %. Uji me shumicë 0. Numri total i kontratave kanalizime 1369 kur ka qenë 1359 , realizimi 101 %. Norma e mbulimit me kanalizime e popullatës në zonën e shërbimit 3794, plani i buxhetit ka qenë 3760, 101 %. Numri i kontratave familjare realizimi 1224 kur plan buxheti ka qenë 1213, 101 %. Numri i kontratave biznes 128, plani ka qenë 130, 98 %. Numri i kontratave institucione është realizuar 17 kur plan buxheti ka qenë 16, 106 %. Indikatori i kontratave totale për 12 mujorin e vitit 2023 krahasuar me buxhetin kemi një realizim 100 % përkatësisht : Kategoria familjare 100 % realizimi me buxhetin. Kategoria biznes 100 % realizimi me buxhetin. Kategoria institucion 102 % realizim me buxhetin. Duke filluar nga Janari 2023 nga ana e SO-ve ka filluar puna për evidentimin e lidhjeve të paligjshme dhe formalizimin e tyre duke i pajisur me kontratë e cila pritet të reflektojë në rritjen e numrit të lidhjeve të reja si dhe të gjitha kontratat e reja të hapura në NJO Rrogozhinë janë pajisur me matës. Në numrin e lidhjeve me matës vihet re një realizim prej 97 % krahasuar me buxhetin. Për indikatorin e kontratave totale me kanalizime për 12 mujorin 2023 krahasuar me buxhetin kemi një realizim me 101 % përkatësisht: Kategoria familjare 101 % realizimi me buxhetin. Kategoria biznes 98 % realizimi me buxhetin. Kategoria institucion 106 % realizimi me buxhetin.

Hekuran Xhani . Me leje më fal që po ju ndërpres, këto informacione mund të ja paraqitni për mendimin tim drejtorisë së përgjithshme . Ne këtu presim nga ti çfarë masash keni marrë ju si drejtori...

Shpati Kolgega . Ta mbarojë parashtrimin ...

Hekuran Xhani . 20 faqe material nuk i nevojiten këshillit se sa kontrata ka lidhur dhe zgjidhur ujësjellësi ne duam si këshill sa orë ujë furnizohen qytetarët e bashkisë.

Dafina Gjini . E kam më poshtë dhe atë.

Shpati Kolgega . Ta lëmë ta mbarojë mbase e ka.

Hekuran Xhani . T'i japim mundësi mos të lodhet duke e lexuar ta shkurtojë.



Dafina Nuka . Po mirë ta lexojë Visi pra.

Mukades Gixhari . Ta kthejmë në formë bashkëbisedimi?

Shpati Kolgega . Unë them ta mbarojë ose ta përmbledhi.

Besnike Coraj . Kryetare drejtoresha të dali tek pjesa që i tha z. Xhani, tek shërbimi tek cilësia tek furnizimi.

Shpati Kolgega . Kryetare më fal bëjmë një gjë të mbarohet raportimi pastaj secili bën pyetje ngre shqetësime... pra unë dua ta dëgjoj deri në fund.

Silvana Aliu . Ne na intereson se sa është shërbimi në terren.

Shpati Kolgega . Më interson mua ta dëgjoj.

Mukades Gixhari . Respektojmë mendimin e Shpatit.

Dafina Gjini . Siç vihet re për NjO Rrogozhinë për volumin e ujit të faturuar kemi një realizim në total 101 % përkatësisht: Kategorinë familje kemi një realizim 108% me buxhetin. Kategorinë privat kemi një realizim 104 % me buxhetin. Kategorinë Institucion kemi një realizim 110% me buxhetin. Siç vihet re për volumin e kanalizimeve për NJO Rrogozhinë kemi një realizim në total 109 % përkatësisht kategorinë private kemi një realizim 111% me buxhetin. Kategorinë institucion kemi një realizim 116% me buxhetin. Totali i të ardhuravenga uji i faturuar+Kanalizime+Tarifë shërbimi 26,082,460 në buxhet parashikuar 24,409,792 me një realizim 107 %. Ecuria e volumit të ujit të faturuar dhe kanalizimeve reflektohet edhe në të ardhurat e gjeneruara nga faturimi. Siç vihet re për NJO Rrogozhinë kemi një realizim 107 % përkatësisht: Kategoria Familjare ka realizim 106%. Kategoria privat ka realizim 103%. Kategoria Institucion ka realizim 111%. Niveli i arkëtimit për Nj. Op Rrogozhinë gjatë 12 mujorit 2023 për njësinë operative Rrogozhinë kemi një realizim me 101 % të arkëtimitve totale me vlerë leku (nga faturat e UKD) 99% të arkëtimit korent dhe 103 % të arkëtimit të prapambetur. Norma e arkëtimitve total është 99% për vitin 2023. Vlera e arkëtuar totale (faturat UKD + të tjera) për këtë periudhë ka realizim prej 99% krahasuar me vlerën e buxhetin për njësinë e Rrogozhinës.

Fatmira Thartori . Ajo po thotë të ardhurat paguhen por shërbimi akoma... këtë duam ne shërbimin ...



Silvana Aliu . Ai i paguanka por ti nuk çon shërbimin.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me shërbimin ta dëgjojmë drejtoreshën.

Dafina Nuka . Indikatorët nga ana ekonomike lidhen me njëri tjetrin, po nuk ishte shërbimi nuk çon në realizimin ose unë çoj një ujë atje dhe kur e çoj me pisllek për mua nuk është realizim .

Silvana Aliu . Nuk më duhet mua 101, 102 kur Lekaj ka 2 ditë pa ujë.

Dafina Nuka . Në këto momente që flasim ka ujë, Gërmenj ka qenë një pompë 15kë është ndryshuar pompa është vënë një pompë 22 kë, kam qenë unë në ndjekje të detyrave dhe Lekaj sot që flasim nuk ka asnjë problem me ujin. Ne merremi me shërbimin merremi me defektin nuk e detyrojmë dot t'i hyjmë tjetrit në shtëpi natën që vadit ai në orën 9 të darkës.

Fatmira Thartori . Më fal Dafina ishte pjesa tek vjedhja e ujit në qoftë se ti ke kanalizimin ke shërbimin, këtu futet e gjitha e dashur. Aty ku dyshihet bashkë me punonjësit e bashkisë, policisë bashkiake ti shkon tek zotëria dhe bën monitorimin e asaj pjese, kurse tjetri që ty të paguan cent më cebt shërbimin ti do i çosh shërbimin jo të jetë në majë të kodrës kudo të jetë në Thartor, më fal ti mua tani ndërpirte atë pjesën më fal... ai të paguan centin dhe ti do i shërbesh se ka vjedhje se nuk ka vjedhje ai tjetri nuk do ta dijë, në rregull. Dhe pjesa tjetër e Gosës që i le dy ditë pa ujë jo një kur ju merr në telefon juve ju nuk e hapni telefonin. Pse more zotëri ju jeni në shërbim të popullit, jo në shërbim të vetes tuaj, përderisa ju keni marrë një pozicion të lutem mos më ndërprit duhen shërbimet e popullit se është e Shtunë se është e Dielë se është darkë se është mëngjes duhet uji jo të rrijmë tre ditë pa ujë e të mbledhim pikat e shiut. Tjetër ka qenë mes vere para një jave dhe nuk më ka ardhur uji është ndërpre tuba nuk është ndërpre tuba është e Shtunë është e Dielë duam ujin. Këto problematika të mos jenë më sepse atë lek ta jap cent më cent i gjithë komuniteti.

Dafina Nuka . Unë kam qenë me leje të jam përgjigjur nëse të kujtohet. Ka pasur problem firma ndërtuese ...

Fatmira Thartori . Nuk dua ta di ku do shkoj unë...

Dafina Nuka . Kemi shkuar e kemi riparuar...

Fatmira Thartori . 2 ditë?



Dafina Nuka . Unë jam përgjigjur dhe i kam thënë këtu brenda në kanal...

Silvana Aliu . A është e vërtetë që boti që përdorin njerëzit për pastrimin e ujërave të zeza është prishur? Dhe i duhet një banori të marri nga Gosa privat.

Dafina Nuka . Ja kemi përcjellë që është prishur. Të dyja zonat bregdetare kanë vetëm ujë kanalizime jo është nga ora 08;00 deri në 19;00 në zonën e Vilë Bashtovës furnizohet me ujë 24 orë ndërsa në vijën bregdetare nuk ka rrjet furnizimi me ujë zonat e bregdetit furnizohen... Rrogozhina është 24 orë dhe aty nuk vidhet nuk më vjen njeri në zyrë të më thotë nuk ka ujë në Rrogozhinë. 3-4 që dyshonim i kemi parë i kemi shkuar kemi bërë relacion është një drejtori mbi ne që është task forcë që varet nga Ministrja dhe ajo në bazë të relacionit që bëjmë ne vjen kontrollon në banesë në institucion.

Fatmira Thartori . Qëparë the që nuk e monitorjmë ne atëherë ...

Silvana Aliu . Quhet vjedhje kur është lidhje e paligjshme...

Dafina Nuka . Ne bëjmë relacionin ku dyshojmë ku na bie shitja ku shikojmë që ai personi atje në Lekaj vadit ai harxhon 49 m³ komshiu i tij 13 dhe vjen thotë unë nuk kam ujë po ja merr ai zotëria tjetër këto verifikime bëjmë ne deri këtu jemi dhe pastaj bëjmë relacionin tek task forca, ajo vjen me forcat e veta me kamer me të gjitha.

Saimir Cani . Fshtratrat e Njësisë Lekaj kanë problematika me ujin kemi folur shumë herë bashkë.

Dafina Nuka . E ndjek nga afër atë problem që dhe në këto momente mund ta marr punonjës...

Saimir Cani . Nuk ka faj punonjësi nuk i sjellin ujë.

Dafina Nuka . Si nuk i sjellin ujë? Depo ku e çon gjithë atë prodhim? Depo Lekaj prodhon ujë më shumë se gjithë depot se e Gosës se Gosa ka të drejtë me investimin e ri që po bëhet do mbyllet totalisht të gjithë defektet që do ketë Gosa nuk do ketë më probleme me depo kjo do arrohët ne Shtator.

Saimir Cani . Tani kemi dy javë prap pa ujë.

Dafina Nuka . Vjen pak sepse vadisin... Kryeluzaj ka, në Mushnikë ka.



Saimir Cani . Në Mushnikë nuk ka fare.

Hekuran Xhani . Sa orë ujë i çoni banorëve të Zanbishës?

Dafina Nuka . Ne jemi munduar ta bëjmë kordinimin në atë mënyrë që të marrin të gjithë zonat e Zanbishës, sa herë që më ka marrë djali besoj që mbrapa e ke marrë përgjigjen që është sistemuar direkt në kohë apo jo? Na kanë sjellë Indrit na vjen informacioni nga njerëzit që ska ujë se punonjësin do e lajmërosh se shiko se ka dhe bllokime matësash nuk ka vetëm linja ka një defekt. Ne vetëm këtë muaj ne zonën e zotërisë kemi bërë shumë defekte ai e ka parë, i kemi bërë që kanë qenë dhe defekte të vjetra të akumuluar, ti duhet ta kesh parë më mirë se unë se je banor i zonës. Pavarësisht se unë kam shkuar e kam ndjekur defektin por ti ke shkuar e ke parë dhe pasdite, tani në këto momnete s'kemi defekte.

Saimir Cani . Ska fare .

Dafina Nuka . Ju doni me vaditur.

Saimir Cani . Jo nuk dua me vaditur.

Dafina Nuka . Uji është për t'u pirë për t'u pastruar dhe për t'u larë.

Silvana Aliu . Dëgjo ai është anëtar i këshillit dhe po merr gjithë përgjegjësinë dhe po thotë ty që unë në familjen time nuk kam ujë.

Fatmira Thartori . Merr grupin e punës verifikojë sepse ai është përgjegjës për atë pjesë është këshilltar për atë zonë atje.

Dafina Nuka . Ne kemi ngritur grupe pune dhe do vazhdojmë ta bëjmë prap, kush janë me emra do t'i vijë keq Saimirit pastaj kur ata të shkojnë në zyrë përmbarimi.

Fatmira Thartori . Ti bëj pjesën tënde.

Dafina Nuka . Kjo ka ngelur e fundit.

Silvana Aliu . Më fal drejtoreshë jo kjo ka ngelur ti çojë.

Dafina Nuka . Dy ditë që nuk patëm ne e kemi furnizuar ... Saimir blerejet bëhen në Durrës ne



nuk kemi të drejtë të bëjmë, ne bëjmë vetëm kërkesat dhe ne bëjmë planin ato bëjnë rregullimin ne çojmë problematikën.

Saimir Cani . Më fal një sekondë, ka ardhur pompa e re tani hajde të shohim nuk ka ujë.

Dafina Nuka . Si nuk ka, mua më vjen prodhimi.

Saimir Cani . Nuk ka ujë se po bëjmë 700 herë një muhabet.

Dafina Nuka . E vjedhin dhe ai e bën me manovrime një pjesë e bën tek zona poshtë një pjesë tek zona lart një orë e bën tek Mushnika. Pse nuk ndodh në Maj në Prill por ndodh direkt kur fillon vaditja. Ne kemi shkuar kemi lajmëruar një herë dy herë tre herë.

Besnike Coraj . Zonja drejtoreshë të dëgjova disa herë që isha me leje isha pushim e kështu edhe unë kam një profesion njësoj si profesioni jot unë jam infermier edhe sinqerisht gdhij ngrysem, jam familjare si ti me bashkëshort me fëmijë kur më kërkojnë dhe i nevojitet shërbimi im dhe këtë fjalë nuk më pëlqen që e thua jo jam me leje jo po kështu. Në një kohë që e merr këtë detyrë dhe unë jam shumë e pakënaqur me ujin, jetoj në qendër në Gosë në apartamente është tmërrësisht e tmerrshme kush jeton e ka shtëpinë në apartament, të qëndrosh pa ujë është e tmerrshme. Në një kohë kaq të nxehtë... të lutem nuk ka rëndësi emri apo...

Dafina Nuka . Ta gjej unë të shoh sa m³ ti harxhon.

Besnike Coraj . Nuk ka rëndësi emri si qysh tek, unë dëgjova shifrat që ti ke dhënë janë të mbledhura në para... shume herë unë dëgjoj ka marrë pompa ajër në Gosë edhe vjen ujë shumë pak një ktrahurë për këtë çarjen e tubit që po pastrohej kanali shumë probleme. Pastaj ti po thua kjo ankesa që bën ti që ti shikon në terren që ka probleme e gjëra varet se si e çon ti unë vrapoj kur ka nevojë që është me temperaturë edhe ti mund të vraposh në mënyrën e dhënies së informacionit atje ku ti kërkon mbështetje që je ti përgjegjësja këtu për këtë pjesë të shërbimit që marrin njerëzit. Ti je vetë grua dhe duhet ta dish se sa i rëndësishëm është ... ke një sektor një përgjegjësi që sinqerisht, lavdi Zotit kultura shprehet shumë edhe ne duhet sa më shumë të lahemi ndoshta dikur, qëndron dhe kjo e kam dëgjuar se unë jam nga fshati dhe i kam dëgjuar dhe këto që thua ti që hapet dhe vaditet, kontrollojini e di që është problem. Edhe kjo ndarja ka zona për mua që janë fshatra unë i shikoj pak më të lehtë se kanë dhe puse, kurse në apartament ku do ta gjesh pusin. Ne kemi apartamente të vjetër është e tmerrshme me ndenjuri një orë pa ujë.

Dafina Nuka . Me investimin që po bëhet do mbyllet historia e Gosës ma ka thënë dhe



supervizori më tha nuk do ketë më fare probleme Gosa sepse është investim i 2001 por ne i kemi ndenjtur në kokë.

Besnike Coraj . Shpresojmë, unë si banore e asaj zone... mua më intereson të më vijë uji edhe kjo nuk është vetëm e imja është edhe e banorëve të tjerë.

Dafina Nuka . Ke të drejtë .

Besnike Coraj . Të rrish pa ujë në këto ditë kaq të nxehta.

Silvana Aliu . A jeni në dijeni që mbrapa gjimnazit ka pasur prishje të tubacionit ka ndenjtur dy ditë derisa ujërat e zeza kanë kaluar tek ujërat e bardha?

Dafina Nuka . Kur?

Silvana Aliu . Ka afër 1 javë.

Dafina Nuka . Ne kemi një zyrë ankesash që duhet të vish.

Valmira Troka . Thotë tek Arian Koni.

Dafina Nuka . Tek Arian Koni po, mendova këtu prapa gjimnazit.

Mukades Gixhari . Z. Lulzim Hasa.

Lulzim Hasa . Falenderoj drejtoreshën për informacionin, unë jam këshilltar i zonës së Kryevidhit, në 10 muaj ne kemi ujë 24 orë, në dy muaj kemi një ditë po një ditë jo në 24 orë, pra kodrat e Spillesë dhe fshatrat turistike e kanë të zgjidhur problemin e ujit të pijshëm.

Silvana Aliu . Prit prit një ditë po një ditë jo, uji është 24 orë e keni seriozisht ju?

Mukades Gixhari . z. Lulzim shprehu mendimin e tij.

Lulzim Hasa . Nuk është mendim është fakt.

Shpati Kolgega . Unë doja ta përgëzoja drejtoreshën për qasjen që i bën problemeve pavarësisht se probleme do ketë por që e rëndësishme është që qasja të jetë e duhura pra kur ka një problem



shkohet kërkohet zgjidhje kërkohet bashkëpunim kështu që nga kjo pjesë dhe nga të ardhurat dhe performanca që kishte dhe kjo pjesë është e rëndësishme. Kemi parë në gjithë Shqipërinë ujesjellësa që janë me humbje të jashtëzakonshme pra janë institucione që janë të falimentuar kurse në Rrogozhinë ... dmth kjo është shumë e rëndësishme pavarësisht që diku ka ujë diku nuk ka do vazhdojë kjo problematikë nuk besoj se do zgjidhet 100% brenda kësaj periudhe do duhet që të ketë më shumë investime do i kërkoja drejtoreshës që të kërkojë më shumë investime dhe për zonat bregdetare që ne i kemi prioritet, kështu që për performancën bravo.

Fatmira Thartori . Sa është orari që vjen uji në Gosë?

Dafina Nuka . Nuk ke 24 orë por me manovrime 12 orë të ditë ujë i ke.

Fatmira Thartori . Gosa?

Dafina Nuka . Gjithë zona, se ai bën Gosën e Vogël dhe kalon në Kalush.

Fatmira Thartori . Atëherë çdo zonë e Gosës është 12 orë pa ndërprerë?

Dafina Nuka . Po.

Fatmira Thartori . Po unë nuk jetonkam në Kërçukaj.

Dafina Nuka . Po si nuk ke ujë në Kërçukaj tani që po flasim nuk ke 12 orë?

Fatmira Thartori . Më vjen në orën 6 dhe më ikën në orën 8, pastaj vjen...

Dafina Nuka . Të vjen prap...

Fatmira Thartori . Kur?

Dafina Nuka . Nuk e shikon ti kur të vjen prap.

Fatmira Thartori . Unë hapur e le tubën se na rri depozita bosh, një depozitë e kam vënë 10 kuinalëshe poshtë një e kam ngjitur lart në kat të dytë... O zonjë po flet përgjumësh më duket! Se unë jam banore e Kërçukajt prej 20 vitesh në atë vend, mund ta kesh për Gosën lart ndoshta për Gosën lart se ajo ka 24 orë ujë kurse Kërçukaj ka vetëm dy orë ujë në ditë. Nuk ka 12 orë sepse unë jetoj në Kërçukaj e le gjithë ditën tubën hapur. E para, e dyta po të jap mendim që ti



atë ta bësh dy orë paradite, dy orë pasdite ose më tëpr por mos thuaj që ka 12 orë ujë Kërçukaj se është turp që drejtori nuk di sa kohëzgjatje ka në një vend të caktuar.

Indrit Dedej . Drejtoreshë mua më intereson Saimiri, po i shkoi Saimirit je në rregull Fatmira ishalla...

Fatmira Thartori . Unë do hap pus.

Hekuran Xhani . Investimet që bën drejtorja rajonale Durrës në sistemin e ujësjellësit ju i merrni në dorëzim një, kontrollini cilësinë e punës?

Dafina Nuka . Nga Maji i 2023...

Hekuran Xhani . Tani unë po flas sot, para 6 muajsh u bë investim në Lekaj...

Dafina Nuka . Nuk ka mbaruar investimi por ndiqet nga Bashkia Rrogozhinë.

Hekuran Xhani . Nuk e ndjek drejtorja?

Dafina Nuka . Jo sepse Bashkia ka bërë një procedurë tenderimi ka marrë një firmë që po bën Lekajn dhe Gosën atje është një firmë që unë nga ana ime e kam ndjekur por ...

Hekuran Xhani . Nuk është kompetencë e juaja.

Dafina Nuka , Është folur që të bëhet një komision dhe nga Ujësjiellësi dhe nga Bashkia, jemi në pritje të Komisionit unë për vete privatisht me punonjësit që njohim se janë të vjetër i kam thënë shko shikoje. Erdhi një kontroll AKUK se të drejtë ka. ai ka të drejtën e vet se ai ka fondet... deri sipër në fshat po vazhdojnë punimet dhe pritet që në Shtator të bëhet mbyllja e investimit atëherë do ta marri Bashkia në dorëzim, dhe do na e japi ne dhe ne do e fusim në bilncet tona financiare.

Hekuran Xhani . Unë e kisha këtu na telefonon një qytetar atje punimet rëra nuk është hedhur ajo është diçka që kontrollohet edhe pas 3 vjetësh ai që më telefonon është specialist për këtë punë edhe unë i thashë do ta trajtoj. Sepse edhe pas 6 muajsh një denoncim shkon e hap kanalim edhe nuk gjen gurë nuk gjen rërë edhe pastaj... Atëherë të falenderoj drejtoreshë.

Fatmira Thartori . Sugjerimet tona që ne të dhamë mundësisht ti shënoje dhe t'i verifikojë dhe radhën tjetër ...



Dafina Nuka . Ti ke pasur dhe kontaktin çdo kohë me mua nuk të ka munguar asnjëherë as telefon...

Fatmira Thartori . Jam dakord me atë pjesë po nuk bëhet fjalë vetëm për Fatmirën bëhet fjalë për gjithë komunitetin...

Dafina Nuka . Ti ke përfaqësuar zonën...

Fatmira Thartori . Një, dy, tre pika që Fatmira ti tha sot, dikush ti tha sot merri shënim dhe verifikoji bëj një grup pune dhe ...

Mukades Gixhari . Drejtoresha faleminderit për informacionin me detaje që na dhe. Vazhdojmë tek të ndryshmet. Shqyrtim i kërkesës së nxënësit Aleks Xhavara për mbështetje financiare për mundësimin e studimeve të larta. Kemi drejtorin e mirëqënies dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Nxënësi është ekselent...

Hekuran Xhani . Një muaj ka, kur të miratohet në Prefekturë se vendimi hyn në fuqi pasi kthehet përgjigja.

Ledian Hasani . Nuk e kam lexuar fare si kërkesë unë po rri për korrektësi.

Hekuran Xhani . Kërkesa është këtu por nuk ka përcaktuar shifër.

Alime Hoxha . Ky ka dhënë një shifër ku thotë që tarifa e shkollës së lartë është diku tek 35-40 mijë lekë të reja, shpenzimet mujore 10 mijë lekë, qiraja 15 mijë lekë...

Silvana Aliu . Sa nxënës janë?

Ledian Hasani . Ky nuk është projektvendim akoma, do rigjykohet do e shoh dhe mundësitë që kemi ne financiare.

Silvana Aliu . Edhe unë kërkova për shëndetin radhën e kaluar edhe nuk u miratua.

Alime Hoxha . Unë për aq sa jam nmë dijeni është një nxënës i mirë nuk mund të themi që është ekselent por është nxënës i mirë që përpiqet është një nxënës që ka punuar edhe vetë ka një



familje me probleme siç tha dhe Ledi që janë me probleme dhe ai është nga ata fëmijë që ju të gjithë e dini që shet misra në rrugë. Siç e the dhe ti po mund të ketë shumë të tjerë si puna e atij, kjo është e vërtetë kemi shumë nga ata që janë me vështirësi ekonomike por duke parë nga këndvështrimi që thashë është një fëmijë që ka punuar vetë dhe është munduar për të arritur diçka nëse Bashkia ka mundësi për t'i akorduar një fond ndoshta jo kaq sa kërkon, unë e mbështes pastaj pjesën tjetër e keni ju vetë në dorë.

Hekuran Xhani . Kjo është e disata herë që ne i diskutojmë të gjitha problemet edhe kush jeton në Shqipëri me familje sot e ka të vështirë të shkollojë fëmijët edhe shteti në qendër dhe në bazë funksionon duke i ardhur në ndihmë njerëzve. Unë kam kërkuar çdo kërkesë që ka ardhur për familjet në rast se ky djalë është i aftë për të vazhduar studimet qeveria vendore duhet t'i vijë në ndihmë në mënyrë urgjente as nuk e di ku rrinë as nuk e di ku e ka shtëpinë por detyra jonë si këshill është të përfaqësojmë dhe mbrojmë interesat e qytetarëve tanë dhe fëmijëve tanë. Jo vetëm ky por cilido, le ta lejmë fundja edhe rezervuarin atje dhe t'i lejmë çfarë është për t'u lënë e ti hapim dritën jeshile fëmijëve tanë. Unë jam pro miratimit të kërkesës.

Ledian Hasani . Kërkesën do ta verifikojmë.

Shpati Kolgega . Do bëhet një situacion sa mund të jetë ndihma...

Ledian Hasani . 100 mijë lekë ja heq shkolla në muaj se është familje me ndihmë ekonomike.

Alime Hoxha . Edhe qeranë 150 mijë lekë nuk ka pse ta paguaj se ka konviktin.

Shpati Kolgega . Tarifa është kryesore në parim jam dakord.

Ledian Hasani . Në qoftë se jeni vetëm për tarifën ok... Doja të ju sqaroja për ca shifra këtu se nuk e dija fare kërkesën shpenzime mujore ja heq shkolla se është familje me ndihmë ekonomike, do marri vërtetimin tek zyra jonë dhe i hiqet. Qiraja si tha zonja nuk është aq e lartë, kurse ...

Hekuran Xhani . Ledio një sekondë, kjo kërkesë këtu ka ardhur tek zyra jote? I nderuar sekretar i këshillit kërkesat që vijnë dhe dokumentacioni duhet t'i përcillen përpara zyrave përkatëse që mbulojnë si të arsimit si të përkrahjes sociale. Pra kys ot ne çfarë bëjmë miratojmë kërkesën sot, mbas dy muajsh do miratojmë vendimin për të kaluar sasinë financiare që do përfitojë ky. Pra këto kërkesa është mirë që të adresohen duke mbështetur dhe Silvanën në rast se ka dhe fëmijë të tjerë të aftë për të vazhduar studimet ne sikur t'i heqim qeranë ose t'i heqim shpenzimet mesa



mundësi kemi. Po këto kërkesa është mirë të shkojnë tek zyra e Ledios përpara, një kërkesë tek Ledio një tek ai zotëria i financave që thotë ka buxhet bashkia apo nuk ka?

Indrit Dedej . Kemi dërguar disa kërkesa në bashki për informacion dhe asnjëherë nuk na ka ardhur përgjigje.

Mukades Gixhari . Çfarë kërkesash e ke fjalën?

Indrit Dedej . Zonja Silvana ka bërë kërkesë për pastrimin... nuk na ka ardhur informacion që janë të detyruar të na japin informacion...

Mukades Gixhari . Mbarojmë kërkesën dhe vazhdojmë pastaj... Atëherë jeni dakord që ta shqyrtojmë ...

-Miratohet kërkesa e nxënësit Aleks Xhavara me Nr.2979. Prot datë 10.07.2024 për t'u vlerësuar nga drejtorja e Mirëqënies dhe Kujdesit Social dhe sipas rastit për t'i ardhur në ndihmë me anë të një projektvendimi që do t'i paraqitet këshillit bashkiak për miratim.

Shpati Kolgega . Të kalojë kërkesa, ta shqyrtojë bashkia dhe të nxjerri një kosto.

Mukades Gixhari . Po. Kalojmë tek shqyrtim i kërkesës së poetit z. Xhelal Tosku për sponsorizim libri. Drejtori i financës z. Rezart Vogli.

Shpati Kolgega . Unë jam dakord për 1 milion të vjetra për librin... shqyr që e kemi poetin.

Hekuran Xhani . Atëherë e miratojmë mos ta relatojë. Indriti edhe Shpati janë dakord edhe ta kalojmë ta miratojmë kalojmë tek të ndryshmet tjera.

Rezart Vogli . Do vi si projektvendim në mbledhjen e ardhshme.

Mukades Gixhari . Jeni dakord ? Dakord.

-Miratohet me shumicë votash kërkesa me nr.3040. prot e poetit z. Xhelal Tosku për sponsorizimi libri, për t'u vlerësuar nga drejtorja e Financës dhe sipas rastit për t'i ardhur në ndihmë me anë të një projektvendimi që do t'i paraqitet këshillit bashkiak për miratim.

Mukades Gixhari . Kalojmë tek të tjera. Po znj. Fatmira.



Fatmira Thartori . Një zonjë nga Gosa më është ankuar që e kanë hequr nga puna dhe është sanitare në shkollën e Gosës, të shoqin e ka thujse invalid ...ku është drejtoresha e shërbimeve? Merreni në telefon që të vijë të japë përgjigje. I shoqi merr thjeshtë një pagë minimale 180 mijë lekë në muaj vetë del e papunë, një fëmijë e ka nën 18 vjeç, vajza e madhe njëherë punon njëherë nuk punon. Doja të dija tani kjo familje nga ku do ushqehet? Ku do i marri të ardhurat kur vetëm ai 100 mijë lekëshi atij zotërisë nuk i del vetëm thjeshtë për të bërë ilacet që merr për zemrën. Pra edhe njëherë rasti i shoqi është thujse invalid është hequr nga puna dhe është sanitare, vetë mbeti pa punë fëmijën ka për ta mbajtur të shoqin e ka për ta mbajtur, fëmija tjetër njëherë punon njëherë nuk punon nga do ti marri të ardhurat? Zonjës i është premtuar që do të bëhet definitive në Maj, por rroga i është ndërprerë në Qershor. I bie Qershori paguan... Korrik, Gusht Shtatori njëherë ja japin njëherë nuk ja japin ...ku do ushqehet kjo familje? Pse i është bërë ndërprerja e pagës në Qershor, gjysma e pagës i është paguar dhe gjysma tjetër nuk është paguar?

Valmira Troka . Atëherë sanitare ka qenë me kontratë deri në fund të vitit shkollor.

Fatmira Thartori . Atëherë zonja e di që është me kontratë por zonja e di që do bëhet definitive dhe do paguhet gjatë verës. Kur 103 mijë lekë që i merr bashkëshorti dhe thujse e ka invalid, vetëm thjeshtë karroca i mungon që ta tërheqi e ta shtyjë çfarë do paguajë ilacet apo do mbajë gruan fëmijët sepse fëmija tjetër...

Valmira Troka . E di shumë mirë problemin e di që edhe i është thënë që do vendoset definitive por nuk është se i ka ardhur pengesa nga Valmira ...

Fatmira Thartori . Më fal nuk i përmenda emër...

Valmira Troka . Atëherë me personin dje kam pasur një debat të tillë dhe gishti drejtohet nga Vali dhe duke e ditur shumë mirë ... dhe unë akuzohem pse nuk më ke hapur telefonin zotëria që ti përmend.

Fatmira Thartori . Edhe njëherë mos përmendim emra, si do marri zgjidhje kjo punë...?

Valmira Troka . Atëherë unë zgjodhjen e kam dhënë që kur i ka mbaruar kontrata pastaj se si është problemi dhe se si është mundësia bashkisë për ta futur definitive i di zyra përkatëse, i di zyra juridike ato nuk i di Valmira. Valmira mund të premtojë dhe mun të ketë shumë dëshirë që ajo zonjë mos të rrintë asnjë ditë pa punë.

Fatmira Thartori . Ajo ka mbetur pa punë edhe kur ka qenë në punë nuk është paguar.



Valmira Troka . Se i ka mbaruar kontrata se ka qenë me kontratë.

Fatmira Thartori . Edhe njëherë dy javë ka punuar dhe nuk është paguar. Dy javë ka punuar në Dhjetor apo në Qershor edhe në Mars një gjë e tillë dhe nuk është paguar.

Valmira Troka . I ka mbaruar kontrata dhe i është ribërë kontrata në Janar.

Fatmira Thartori . Unë dua që të zgjidhet dhe t'i japim zgjidhje se të gjithë... situatës.

Shpati Kolgega . Zonja do punë. apo do të rri sanitare aty?

Fatmira Thartori . Sanitare aty ku ka qenë.

Shpati Kolgega . Po deshi punë kërkon gjithë bregdeti kërkojnë sanitare nga mëngjesi deri në darkë.

Fatmira Thartori . Shpat nuk i jep zgjidhje situatave, i jep dikush tjetër që i është premtuar vendi aty asaj.

Hekuran Xhani . Vali thotë anën ligjore sepse ajo është me kontratë, tani kjo familje ndryshon në bazë të diskutimit që bëri zonja dhe këshilli ... Shpati këshilli merret me këtë punë...

Shpati Kolgega . U sqarua situata ...

Fatmira Thartori . Jo nuk jam sqaruar, ti mund të ikësh Shpati...

Shpati Kolgega . E kanë hequr nga puna i ka mbaruar kontrata.

Valmira Thartori . Tani nuk ka fare lidhje me mua, pavarësisht se unë e kam marrë përsipër një gjë se edi shumë mirë problemin në ç'situatë është familja dhe e kam premtuar unë që do ta rregulloj prandaj po e njoh shumë mirë. Jo më larg se dje kur kam pasur kontaktin se unë e kisha lënë diku tjetër shënim që kjo duhet të rregullohet se s'bën pavarësisht se ka pasur jo mos dëshirë por duhet gjendur tani dhe mundësia.

Hekuran Xhani . A mund të bëhet definitive kjo që ditën që i ka mbaruar kontrata?

Valmira Troka . Po, bëhet.



Hekuran Xhani . A ka mundësi bashkia ta bëjë? Jepja zgjidhjen.

Alime Hoxha . Zonja ka qenë me kontratë. Sa ka qenë kontrata?

Valmira Troka . Deri në fund të vitit shkollor.

Alime Hoxha . Kur është bërë në fillim Shtatori?

Valmira Troka . Po. Dhe bëhet me 6-mujorshe sipas ligjit.

Alime Hoxha . Po tani 6-mujori kur mbaron?

Valmira Troka . Në fund të vitit shkollor në Qershor, me 15 Qershor mbaron shkolla. Atëherë bëhe nga Shtatori që fillon shkolla deri në fund të Dhjetorit.

Alime Hoxha . Atëherë është tre muaj?

Valmira Troka . Tre muaj pastaj nga Janari deri në fund të vitit shkollor bëhet 6-muaj, 9- muaj.

Alime Hoxha . Tani unë kam një pyetje tjetër. A ka vend që kjo zonja të bëhet definitive?

Valmira Troka . Po.

Alime Hoxha . Ka mundësi, e keni hapësirën?

Valmira Troka . Po, është hapësira.

Alime Hoxha . Pse nuk është bërë?

Valmira Troka . Nga rruga ligjore po them është mundësia dhe është lënë që kjo të bëhet këto ditë.

Alime Hoxha . Në rregull, a ka mundësi që të rregullohet?

Fatmira Thartori . Pse duhet të ishte bërë debati para kur është miratuar.

Valmira Troka . Debati bëhet se është dëshira për t'u bërë debati.



Mukades Gixhari . Faleminderit Valmira.

Silvana Aliu . Kam bërë dy kërkesa një për kontratën e sportit, një për kontratën e plehrave të qytetit, asnjëra nuk është më kthyer. Kam kërkuar kontratën e futbollit 25% e bashkisë sa respektohet dhe njëkohësisht dhe kontrata për plehrat e qytetit.

Hekuran Xhani . Tani tek të ndryshmet kam dhe unë një pyetje. Kaluam një fond financiar për blerjen e eskavatorit. Një 50 milionësh e dogjëm për paaftësinë tonë për të realizuar këtë burim administrata e bashkisë që ne kryetare e humbëm dhe ne edhe seriozitetin dhe autoritetin tonë si këshilltar. Jemi vetëm tani dhe asnjë përfaësues se çdo vendim që marrim ne...

Valmira Troka . Për eskavatorin ke drejtoreshën e shërbimeve kështu që ta jap unë përgjigjen.

Hekuran Xhani . E dyta sistemi vaditës, ujitjes u mbyll për faqe të zezë megjithatë po shkojmë drejt fundit problem mbetet dy kuintal për dynym grurë kanë bërë gjithë fermerët për dy vjet si rezultat i mosfunksionimit të sistemit të ujit. Gruri pa ujitur nuk bën një humbje kolosale e fermerëve të paktën në fushën e Luzit të Madh në mënyrë urgjente meqë drejtoresha e shërbimeve qenka këtu një informacion të saktë dhe të përshpejtohet puna që të vijë eskavatori të fillojë...

Valmira Troka . Procedurat e eskavatorit kanë 1 javë që janë futur në sistem, presim që të hapet sistemi dhe besoj që nga fillimi i muajit që vjen do jemi gati, dmth ishte miratuar pa ardhur unë.

Hekuran Xhani . Gjithë pyetjet po ty do t'i drejtoj, tani kemi tre specialistë bujqësie nëpër njësitë administrative. Unë të paktën në Lekaj kam agronom dhe çfarë ndodh... ky është diskutim jo debat i thashë atij specialistit të bujqësisë që kemi ne, ti paguhesh nga taksat edhe në 30 ditë, 20 ditë sa i bie me punuar në zyrë të paktën 5 ditë me dalur me shkuar tek fermerët me dhënë një farë asistence edhe më ngriti problemin unë xha 400 mijë lekë marr. Një herë 100 mijë i dua naftë nga Germënji me ardhur në Lekaj me lëvizur me shkuar në Shkozet, Zanbishë me shkuar atje tani çfarë mund t'i ofrohet këtyre specialistëve se në Shqipëri unë e ka m thënë dhe në ato podiumet politike raketa nuk prodhon avionë se kaq jemi ne. Ne bujqësinë kemi, shqiptarët me bujqësi merren të paktën t'i ndihmojmë t'i japim mundësinë e ke vaditur misrin, pra duhet patjetër asistencë e specialistit pranë fermerit për t'i krijuar kushte të paktën ti japë për 5 mundësinë për të lëvizur t'i jepet naftë. Unë e kam bërë debat ballë për ballë dhe jo më larg se dje i kam thënë.

Valmira Troka . Atëherë në qoftë se duhet me nxjerrë justifikim jo nuk shkoj dot aty nuk shkoj



dot atje kush ka dëshirë me punuar e gjen mundësinë. Edhe unë drejtoreshë shërbimesh jam edhe kjo që kërkohet, kërkohet nga unë, jo më larg se dje kam shkuar në Spille se kisha probleme me ujërat e zeza dhe kam shkuar pas orës 4 që kam mbaruar ounë këtu dhe jam kthyer në shtëpi në orën 9 edhe unë kam një familje edhe unë kam shpenzime dhe kam shkuar me makinën time.

Hekuran Xhani . Po naftën kush e ... Kam punuar xhaji shumë në qeverisjen vendore ...

Valmira Troka . Me xhepin tim.

Hekuran Xhani . Nuk jam dakord të shkosh me xhepin tënd.

Valmira Troka . Atëherë kur ke një emergjencë dhe unë nuk e gjej mundësinë që të rrijë unë tani të presi emergjencia atje derisa të mundësojë bashkia të më japë naftën nuk është e drejtë që ta lësh një emergjencë për të pritur ...

Hekuran Xhani . Ore emergjencë tha ajo infermierja në 2 të natës do shkojë t'i bëjë sërumin njerëzve nuk është emergjencë për të kryer...

Valmira Troka . Edhe infermierja që shkon tek puna vet si shkon? Shkon me xhepin e vet, e gjen mundësinë?

Hekuran Xhani . Po.

Valmira Troka . Atëherë kush do të punojë e gjen mundësinë.

Hekuran Xhani . Tani dëgjo ajo merr 300 mijë lekë rrogë nuk i ofrojmë shërbim qytetarëve ne po nuk i zgjidhëm rrugët për të ecur përpara. Unë këtu kam kërkuar me të madhe t'i jepet rroga maksimale administratës për t'i shërbyer. Tani bashkia ka buxhet apo nuk ka edhe të ndahet kjo naftë, zyra e shërbimeve...

Valmira Troka . Atëherë nga momenti që ka ardhur të gjithave drejtorive të bashkisë Rrogozhinë i kam kërkuar një plan pune lëvizje që unë të shpërndaj naftën dhe unë nuk mund ta shpërndaj naftën sikur po shpërndaj karamelë. Planin e punës së lëvizjes ku do lëvizësh ku do shkosh, çfarë do bësh.

Besnike Coraj . Valmira kush i ka vënë ato dy bordurat kur shkohet në Vilë atje tek ajo godina?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Valmira Troka . Ku godinë?

Besnike Coraj . Sa mbaron që nis rruga e re, janë dy ndarëse betoni atje thyen qafën. Po kush i ka dhënë të drejtë?

Valmira Troka . Askush nuk i ka dhënë të drejtë do hiqen dhe do vihen policë të shtrirë. Kam marrë policë të shtrirë, po mbulojmë pjesën e Rrogozhinës dhe do dal në Gosë.

Mukades Gixhari . Shikoje Valmira këtë pjesë. Ndonjë diskutim tjetër? Znj. Alime.

Alime Hoxha . Edhe pjesa e lagjes aty lagjja e serave, a ka ndonjë plan për kanalizimin e ujërave të zeza?

Valmira Troka . Tani deri tani unë nuk dua të flas...

Silvana Aliu . Tani si u shtruan këto rrugët pa u bërë kanalizimet?

Alime Hoxha . Edhe aty tek Big Marketi është një pusetë që unë e kam ngritur dhe herë tjetër u hap njëherë ajo, është pusetë e ujërave të bardha aty ajo është bllokuar , e hapën njëherë këto të bashkisë aty gjithë uji i shut që bie futet dhe i shkon në shtëpi familjarëve, kullon gjithë rruga merren gjithë ujërat dhe ikën uji poshtë i shkon atyre tek oborri, ajo puseta është hapur e bënë njëherë gati për një kapak e lanë prap pa rregulluar.

Mukades Gixhari . Meqë nuk kemi më diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Ju faleminderit.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 12 : 00^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati rreth 02 orë ; 06 min ; 28 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 36 (tridhjetë e gjashtë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera

-36-